Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)
LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa çmim do të konsiderohen si artikujt të pa ofruar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					
Vula					
Datë _____					

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentet e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentet e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojce për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Skicimet, parametrat teknik etj.:

Specifikimi i Materialeve

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Rakorderitë Polipropilen

Rakorderitë shërbejnë për bashkimin dhe përshtatjen e tubave ose rakorderive plastike me përmasa të ndryshme. Trupi i rakorderive të jetë material Polipropilen me rezistencë mekanike të lartë. Produktet duhet të jenë të bombarduara me rreze ultraviolet në mënyrë që mos të krijojnë alga ose baktere. Gjithashtu këto rakorderi nuk duhet në asnjë mënyrë të krijojnë mikroorganizma në ujë të pijshëm. Sipërfaqja e brendshme e produkteve duhet të jetë homogjene dhe nuk duhet të jetë poroze. Produktet nuk duhet të përmbajnë asnjë tip substancë që ndryshojnë shijen ose aromën e ujit. Presioni i punës të jetë 16 bar (ose më i lartë), bazuar në standartin ISO 1167-1 dhe ISO 1167-4 (ose ekuivalentet e tyre). Metoda e testimit për të kontrolluar nëse ka rrjedhje pas shtrëngimit të rakorderive në tubin plastik duhet të jetë sipas ISO 3458 ose ekuivalent. Rezistenca mekanike e shtrëngimit të rakorderive kundrejt tërheqjes së tubit duhet të jetë testuar sipas standartit ISO 3501 ose ekuivalent me të. Rakorderitë duhet të jenë konform ISO 17885 dhe ISO 3503 (ose ekuivalente të tyre). Filetimi i tyre të jetë sipas standartit ISO 7-1 ose ekuivalent. Ndryshimi në dimensionet e produkteve të jetë maksimumi ± 0.5 mm nga dimensionet e kërkuara nga AK.

RAKORDERITË XINGATO

Këto rakorderi të shërbejnë për lidhjen dhe/ose degëzimin e një tuboje ose rakorderie me ato tubo ose rakorderi të tjera me përmasa të njëjta ose të ndryshme. Rakorderitë duhet të jenë material xingato i tipit EN-GJMË-400-5 (ose ekuivalent) dhe të kenë të shkruar në trup emrin e kompanisë prodhuese ose markën. Forca që ajo duhet t'i rezistojnë është minimalisht 35000 N/cm² pa u deformuar, dhe të kenë rezistencën shkallë formimi të paktën 210 HB. Rakorderitë duhet të jenë të mbuluar me zink në sasi minimalisht 450gr/m². Shtresa e zinkut duhet të jetë minimumi 65µm. Filetimi i rakorderive duhet të jetë sipas standartit ISO228/1 ose ekuivalent. Presioni që duhet të durojnë të jetë minimumi 25 bar në temperaturën nga -20°C deri në 100 °C. Të gjithë produktet duhet të jenë të certifikuara për përdorim në ujë të pijshëm dhe të kenë certifikatë sanitare. Ato duhet të jenë sipas standartit EN10242 (ose ekuivalent). Përmasat e rakorderive përkatësisht sipas preventivit.

Fije Lini

Fija e linit është një element ndihmës për përforcimin e lidhjeve të rakorderive me fileto ndërmjet njëra-tjetrës dhe minimizon mundësitë që të ketë rrjedhje uji gjatë këtyre lidhjeve.

Rakorderitë HDPE EF dhe rakorderitë HDPE

Rakorderite PE EF dhe rakorderitë PE duhet të jenë të prodhuara me plastikë HDPE 100 të pastër dhe jo plastikë të riclikuar, për tu përdorur në linjat e furnizimit me ujë të pijshëm. Ato duhet të kenë të shënuara në trup gjithë të dhënat për saldimin. Densitetit i materialit PE në këto manikota EF dhe në këto rakorderi PE të jetë minimumi 0.95g/cm^3 . Elektromanikotat dhe rakorderitë PE duhet të jenë në përputhje me standartin ISO 4427 ose ekuivalent me të. Moduli i tërheqjes së materialit HDPE të jetë testuar dhe më pas gjetur të jenë në përputhje me standartin ISO 527-2 ose ekuivalent me të. Po ashtu sforcimi i tërheqjes deri në këputje të materialit HDPE të këtyre manikotave EF dhe rakorderive PE, të jetë testuar dhe gjetur të jetë në përputhje me standartin ISO 527-2 ose ekuivalent me të. Ky material duhet të jetë i aftë të durojë deri në **25 Mpa** para se të këputet. Përmbajtja e të zezës në karbonin e këtyre elektromanikotave dhe rakorderive PE mos të jetë më pak se 2% dhe ky faktor të jetë testuar dhe gjetur të jetë në përputhje me standartin ASTM D 1603. Koha e induksionit të oksidimit të manikotave EF dhe rakorderive PE në 210°C mos të jetë më pak se 20 minuta. Këto elektromanikota dhe rakorderi PE duhet të jenë të forta dhe rezistente ndaj plasaritjeve, por nëse plasaritja ndodh, atëherë ato duhet gjithashtu të jenë rezistente në mënyrë që këto plasaritje mos të hapen më tej, dhe kjo të jetë në përputhje me standartin ISO 13477 dhe ISO 13479 ose ekuivalente me to. Duhet të jenë të certifikuar për përdorim në ujë të pijshëm dhe të shoqërohen me certifikatat përkatëse. Për të treguar përputhshmërinë me standartet e përmendura më sipër, pranohen dhe përmendja e këtyre standarteve në katalogët që do të ofrohen për elektromanikotat dhe rakorderitë PE të kërkuara.

TUBOT HDPE

Tuba polietileni me dendësi të lartë. Te jenë sipas standartit EN 12201 ose ekuivalent me të. Tubat të kenë një koeficient sigurimi minimalisht 1.20. Materialet e përdorura për prodhimin e tubave të jene jo toksike dhe të mos ndikojnë në cilësinë e ujit (mos t'i japin atij as aromë, as shije). Të jenë fleksibël dhe me rezistencë ndaj vibrimeve dhe goditjeve sizmike, për tu përshtatur me relievin e tokës. Të jenë rezistentë ndaj rrezeve ultraviolet dhe ndaj temperaturave **-25°C deri në $+55^\circ\text{C}$** . Të kenë rezistencë të lartë ndaj gërryerjes dhe jetëgjatësi të paktën 50 vjet. Pamja e jashtme: të kenë sipërfaqe të lëmuar dhe pa dëmtime, prerja fundore e tubit duhet të jetë e pastër dhe në kënd të drejtë me qendrën e tubit. Produktet duhet të kenë certifikatë aprovimi nga të paktën 1(një) institucion ndërkombëtar ose kombëtar për përdorimin për ujë të pijshëm (p.sh DVGW). Përmasat dhe presionet e punës së tubove përkatësisht sipas preventivit.

SARAÇINESKA GIZE PN25 dhe PN40

Dimensionet e saraçineskave duhet të jene sipas standarteve EN 558-1 (ose ekuivalente). Lidhjet fundore të fillanxhave duhet të jenë sipas standarteve EN1092-2 (ose ekuivalent). Testimi dhe dizenjimi i tyre në përputhje me standartet EN 1171 (ose ekuivalente). Boshti i saraçineskës të jetë AISI 420 me fileto sipas standartit EN 10088-1 ose ekuivalent. Temperaturat e punës së saraçineskave të jetë nga 0°C deri në $+60^\circ\text{C}$ (pranohet edhe diapazon më i gjerë që përfshijnë diapazonin e kërkuar). Trupi, mbulesa dhe porta e saraçineskës të jenë material gize (EN-GJS-500-7) sipas standartit EN 1563 ose ekuivalent me të. Dadot, bulonat dhe rondolet e saraçineskës duhet të jenë të zinkuara prej çeliku sipas EN ISO 898-1; EN ISO 898-2 ose ekuivalente me to. Veshja brenda dhe jashtë e saraçineskës duhet të bëhet me bojë epokside minimumi $250\mu\text{m}$. Timoni i saraçineskës duhet të jetë çelik i shtypur në gizë dhe të bëhet sipas standarteve EN 10305-3 dhe EN 1563 ose ekuivalente me to.

Saraçineska bronzi F

Saraçineskat prej bronzi duhet të jenë me levë, të punojnë në presion jo më të vogël se 16 bar dhe në temperaturë -15°C deri +110°C. Saraçineskat duhet të kenë mbyllje sferike me kalim të integruar dhe hapje pozicionale. Të dy fundet e saraçineskës duhet të kenë filetim femër dhe të jenë konform standartit EN ISO 228 (ose ekuivalent). Si trupi dhe komponentët e tjerë të saraçineskës duhet të jenë prej bronzi. Në saraçineskë duhet të jetë e shënuar të dhënat bazë si madhësia e saraçineskës, emri i kompanisë prodhuese ose ndonjë shenjë e markës etj. Të jenë të certifikuar për përdorim për ujë të pijshëm.

Përmasat e Saraçineskave të kërkuara në preventive janë:

Saraçineska 2". Të ketë gjatësi minimumi 100 mm. Gjatësia totale e pjesëve të filetuara të jetë minimumi 35 mm, pra minimumi 17.5 mm nga secili krah. Leva e saraçineskës të jetë minimumi 140 mm dhe lartësia totale e saraçineskës të jetë minimumi 110 mm.

Saraçineska 1 1/2". Të ketë gjatësinë minimumi 85 mm. Gjatësia totale e pjesëve të filetuara të jetë minimumi 33 mm, pra 16.5 mm nga secili krah. Leva e saraçineskës të jetë minimumi 140 mm dhe lartësia totale e saraçineskës të jetë minimumi 100 mm.

Saraçineska 1 1/4". Të ketë gjatësi minimumi 75 mm. Gjatësia totale e pjesëve të filetuara të jetë minimumi 31mm, pra 15.5 mm nga secili krah. Leva e saraçineskës të jetë minimumi 110 mm dhe lartësia totale e saraçineskës të jetë minimumi 82 mm.

Saraçineska 1". Të ketë gjatësi minimumi 65 mm. Gjatësia totale e pjesëve të filetuara të jetë minimumi 29 mm, pra minimumi 14.5 mm nga secili krah. Leva e saraçineskës të jetë minimumi 98 mm dhe lartësia totale e saraçineskës të jetë minimumi 70 mm.

Saraçineska 3/4". Të ketë gjatësi minimumi 55 mm. Gjatësia totale e pjesëve të filetuara të jetë minimumi 25 mm, pra minimumi 12.5 mm nga secili krah. Leva e saraçineskës të jetë minimumi 98 mm dhe lartësia totale e saraçineskës të jetë minimumi 64mm.

Saraçineska 1/2". Të ketë gjatësi minimumi 45 mm. Gjatësia totale e pjesëve të filetuara të jetë minimumi 22 mm, pra minimumi 11 mm nga secili krah. Leva e saraçineskës të jetë minimumi 80 mm dhe lartësia totale e saraçineskës të jetë minimumi 51 mm.

Saraçineska bronzi F

Saraçineskat prej bronzi duhet të jenë me levë, të punojnë në presion minimumi 20 bar dhe në temperaturë -8°C deri +95°C. Saraçineskat duhet të kenë mbyllje sferike me kalim të integruar dhe hapje pozicionale. Të dy fundet e saraçineskës duhet të kenë filetim femër dhe të jenë konform standartit EN ISO 228 (ose ekuivalent). Si trupi dhe komponentët e tjerë të saraçineskës duhet të jenë prej bronzi. Në saraçineskë duhet të jenë shënuar të dhënat bazë si madhësia e saraçineskës, emri i kompanisë prodhuese ose i markës etj. Të jenë të certifikuar për përdorim për ujë të pijshëm.

Saraçineska 2 1/2". Të ketë gjatësi minimumi 134 mm. Gjatësia totale e pjesëve të filetuara të jetë minimumi 60 mm, pra minimumi 30 mm nga secili krah. Leva e saraçineskës të jetë minimumi 224 mm dhe lartësia totale e saraçineskës të jetë minimumi 132 mm.

Saraçineska 3". Të ketë gjatësi minimumi 130mm. Gjatësia totale e pjesëve të filetuara të jetë minimumi 43 mm, pra minimumi 21.5 mm nga secili krah. Leva e saraçineskës të jetë minimumi 244 mm dhe lartësia totale e saraçineskës të jetë minimumi 145 mm.

Saraçineska 4". Të ketë gjatësi minimumi 160mm. Gjatësia totale e pjesëve të filetuara të jetë minimumi 50 mm, pra minimumi 25 mm nga secili krahu. Leva e saraçineskës të jetë minimumi 244 mm dhe lartësia totale e saraçineskës të jetë minimumi 170 mm.

SARAÇINESKA me fllanxhë

Saraçineskat duhet të jenë modeli G me filetim të boshtit që shërben për kyçjen dhe shkyçjen e saraçineskës, në pjesën e brendshme të saraçineskës. Testimi dhe dizenjimi i tyre në përputhje me standartet EN1074 dhe EN1171 (ose ekuivalente). Dimensionet e saraçineskave duhet të jenë sipas standarteve EN 558-1 dhe DIN3202 (ose ekuivalente). Lidhjet fundore të fllanxhave duhet të jenë sipas standarteve EN1092-2 (ose ekuivalent). Temperatura e punës së saraçineskave të jetë nga -10°C deri në +70°C (pranohet edhe diapazon më i gjerë që përfshijnë diapazonin e kërkuar). Gjuhëza, e cila bën të mundur bllokimin ose jo të rrjedhjes së ujit, duhet të jetë e material gize GJS-500-7 (ose ekuivalent) e kapsuluar në gomë EPDM që lejohet për përdorim për ujë të pijshëm. Trupi i saraçineskës duhet të jetë material gize GJS-500-7 (ose ekuivalent). Boshti i saraçineskës të jetë material i pandryshkshëm inoks 1.4034 (ose ekuivalent) që mos të ketë ndikim në ujin e pijshëm për shkak të gërryerjes nga uji. Saraçineskat duhet të jenë të lyera ose të veshura me bojë epokside minimum 250µm. Dadot dhe Bulonat të jenë material inoks AISI304 (ose ekuivalent), në mënyrë që mos të ndikohen nga erozioni dhe të ndikojnë në mirëfunksionimin e saraçineskës. Produktet duhet të kenë certifikate aprovimi nga të paktën 1(një) institucion ndërkombëtar për përdorimin për ujë të pijshëm (p.sh WRAS etj.).

Saraçineska Bronz me Volant

Saraçineskat duhet të jenë me volant, prej bronzi, të punojnë në presion 25 bar (ose më të lartë) dhe në temperaturë -5°C deri +100°C. Saraçineskat duhet të kenë mbyllje si saraçineskat G. Të dy fundet e saraçineskës duhet të kenë filetim femër dhe të jenë konform standartit ISO 228 (ose ekuivalent). Si trupi dhe komponentët e tjerë të saraçineskës duhet të jenë prej bronzi. Në saraçineskë duhet të jenë shënuar të dhënat bazë si madhësia e saraçineskës, emri i kompanisë prodhuese ose i markës etj. Të jenë të certifikuara për përdorim për ujë të pijshëm.

Fllanxha çeliku

Fllanxhat duhet të jenë çeliku të sheshta dhe sipas standartit EN1092-1 (ose ekuivalent). Të gjitha fllanxhat duhet të kenë presion pune 16 bar.

Fasheta Inoksi

Fashetat e inoksit të jenë inoks (AISI 304 sipas standartit EN 1.4301) ose ekuivalent. Gomina të jetë e ngjitur me fashetën e inoksit me ngjitës të përforcuar me fibra xhami për të pasur jetëgjatësi dhe qëndrueshmëri ndaj temperaturave të larta dhe lagështirës gjatë montimit. Fashetat e inoksit të jenë të certifikuara nga institucione ndërkombëtare për përdorim në ujë të pijshëm dhe të jenë të pajisura me certifikata të tipit ACS, WRAS, BS ose ekuivalente. Pjesa e gomuar e fashetës të jetë gomë EPDM, NBR ose ekuivalente të këtyre materialeve. Goma e përdorur në fashetën e inoksit duhet të jetë e cilësi shumë të lartë sepse ka kontakt të

drejtpërdrejtë me ujin e pijshëm, prandaj ajo duhet të jetë për përdorim për ujë të pijshëm dhe të durojë temperatura deri +150 °C. Të mund të instalohen edhe nën presion pa pasur probleme (pjesa e daljes së filetuar të jetë me tapë që mos të lejojë rrjedhjen e ujit deri në momentin e dëshiruar). Dalja e fashetës të jetë sipas standartit ISO 7 (ose ekuivalent). Fashetat duhet të kenë certifikatë për përdorim për ujë të pijshëm si WRAS ose ekuivalente me të.

Tub fleksibël

Tubi fleksibël duhet të jetë prej material PVC i cilësisë së lartë, i cili përdoret për furnizim me ujë, tharje e thithje dhe për transportimin e lëngjeve të ndryshme gjerësisht për përdorim civil, agrikulturë dhe ndërtim. Tubi duhet të jetë i aplikueshëm në temperaturë nga -10°C deri në +60°C, rezistent ndaj kimikateve, ndaj gërryerjes, ndaj përthyerjes dhe këputjes. Tubi fleksibël duhet të ketë një rreze përthyerje nga 70 deri në 330 mm. Tubi duhet të ketë një sipërfaqe të brendshme të lëmuar në mënyrë që të mos pengohet lëngu që transportohet.

Guarnicion

Guarnicionet duhet të jenë material plastik EPDM (ose ekuivalent) të cilët nuk duhet të kenë asnjë ndikim negativ mbi cilësinë e ujit. Plastika e përdorur për prodhimin e tyre duhet të jetë e certifikuar për ujë të pijshëm.

Kundralvula

Kundralvula të jetë 100% bronz. Mekanizmi i bllokimit të rrjedhjes së ujit në të kundërt duhet të jetë i veshur me gominë. Presioni i punës të jetë minimumi 20 bar dhe temperatura e punës -10°C deri +110°C. Të dy fundet e kundralvulës duhet të kenë filetim femër dhe të jenë konform standartit ISO 228 (ose ekuivalent). Kundralvula duhet të ketë të shënuar të dhënat bazë në trup si madhësia e saj, drejtimin e rrjedhjes etj. Kundralvulat duhe të jenë të certifikuar për përdorim për ujë të pijshëm.

Kundralvula 1". Të ketë gjatësinë minimumi 56mm. Gjatësia totale e pjesëve të filetuara të jetë minimumi 25 mm, pra minimumi 12.5 mm nga secili krahu. Lartësia totale të jetë minimumi 60 mm.

Kundralvula 3/4". Të ketë gjatësinë 50mm. Gjatësia totale e pjesëve të filetuara të jetë minimumi 23 mm, pra minimumi 11.5 mm nga secili krahu. Lartësia totale të jetë minimumi 55 mm.

Kundralvula 1/2". Të ketë gjatësinë minimumi 45 mm. Gjatësia totale e pjesëve të filetuara të jetë minimumi 23 mm, pra minimumi 11.5 mm nga secili krahu. Lartësia totale të jetë minimumi 45 mm.

Kundralvula Gize PN40

Kundralvulat e gizes shërbejnë për STP dhe përdoren për të parandaluar kthimin mbrapsht të rrjedhës së ujit, për të mbrojtur goditjet r grushtit hidraulik. Këto kundralvula duhet të jenë të pajisura me fllanxha sipas standartit DIN EN 1092-2 ose ekuivalent me të. Kundralvula duhet të ketë të shënuar në trup shigjetën që tregon kahun e drejtimit të ujit

dhe të jetë e mundur që këto kundralvula të instalohen në 2 pozicione si horizontal ashtu dhe vertikal. Trupi dhe kapaku duhet të jenë prej gize (EN-GJS-500-7) sipas standartit EN 1563 ose ekuivalent me të. Guarnicioni i kapakut duhet të jetë elastomer EPDM dhe të ketë shënjimin CE sipas standartit EN 681-1 ose ekuivalent me të. Tapa dhe boshti i kundralvulës së bashku me dadot, bulonat dhe rondelet të jenë inoks sipas standartit 10088-1 ose ekuivalent me të. Kundralvulat duhet të jenë të pajisura me mbështetëse bronzi sipas standartit EN 1982 dhe duhet të jenë të lyera mundësisht me bojë blu epokside të përdorshme për ujë të pijshëm sipas standartit DIN 30677 (ose ekuivalente) dhe kjo bojë të jetë e aplikuar elektrostatisht, me një trashësi të barabartë ose më të madhe se 250 µm. Temperatura e punës së këtyre kundralvulave duhet të jetë nga 0°C deri në +60°C (pranohet edhe diapazon më i gjerë që përfshijnë diapazonin e kërkuar).

Fllanxh adaptor mekanik

Trupi i fllanxhë adaptorëve mekanikë të jetë material Polipropilen me rezistencë mekanike të lartë. Produktet duhet të jenë të bombarduara me rreze ultraviolet në mënyrë që mos të krijojnë alga ose baktere. Gjithashtu këto rakorderi nuk duhet në asnjë mënyrë të krijojnë mikroorganizma në ujë të pijshëm. Sipërfaqja e brendshme e produkteve duhet të jetë homogjene dhe nuk duhet të jetë poroze. Produktet nuk duhet të përmbajnë asnjë tip substance që ndryshojnë shijen ose aromën e ujit. Presioni i punës të jetë 16 bar (ose më i lartë) bazuar në standartin ISO 1167-1 dhe ISO 1167-4 (ose ekuivalentet e tyre). Metoda e testimit për të kontrolluar nëse ka rrjedhje pas shtrëngimit të rakorderive në tubin plastik duhet të jetë sipas ISO 3458 ose ekuivalent. Rezistenca mekanike e shtrëngimit të rakorderive kundrejt tërheqjes së tubit duhet të jetë testuar sipas standartit ISO 3501 ose ekuivalent me të. Rakorderitë duhet të jenë konform ISO 17885 dhe ISO 3503 (ose ekuivalente të tyre). Filetimi i tyre të jetë sipas standartit ISO 7-1 ose ekuivalent. Ndryshimi në dimensionet e produkteve të jetë maksimumi ± 0.5 mm nga dimensionet e kërkuara nga AK. Njëra dalje e fllanxhë-adaptorit duhet të jetë me shtrëngim ndërsa dalja tjetër duhet të jetë me fllanxhë të galvanizuar.

Tub çeliku

Tubat e çelikut duhet të jenë të sipas standarteve GB.T17396 ose ekuivalent. Forca e elasticitetit të tyre të jetë minimumi 390 MPa dhe kufiri i tyre i këputjes të jetë minimumi 240MPa. Përbërja kimike e disa nga elementeve përbërës të tubave të jetë si më poshtë:

Sulfuri (S) : 0.034-0.036%

Silici (Si) : 0.16-0.38%

Karboni (C) : 0.16-0.25%

Fosfori (P) : 0.034-0.036%

Mangani (Mn) : 0.34-0.66%

Fasheta PP

Fashetat shërbejnë për krijimin e daljeve të sigurta ose linjave të reja në tubat PE-HD sipas kërkesave. Këto fasheta duhet të jenë me rezistencë mekanike të lartë dhe trupi i tyre të jetë

material Polipropilen. Fashetat PP përveç se duhet të suportojnë presionin 16 bar, gjithashtu duhet të jenë të testuara sipas standarteve ISO 17885 (ose ekuivalente me të). Ndryshimi në dimensionet e produkteve të jetë maksimumi ± 0.5 mm nga dimensionet e kërkuara nga AK. Që të mos krijonjë alga ose baktere, produktet duhet të jenë të bombarduara me rreze ultraviolet. Rakorderitë duhet të kenë një sipërfaqe të brendshme homogjene dhe nuk duhet të jenë poroze. Shija dhe aroma e ujit duhet të mos ndryshojë në mënyrë absolute, pra këto rakorderi nuk duhet të përmbajnë asnjë tip substance që mund të ndikojë në to.

Këto fasheta me kompresion duhet të jenë me unazë përforcuese po ashtu të galvanizuar. Filetimi i tyre të jetë sipas standartit ISO 7-1 (ose ekuivalent).

Fasheta Gize me fileta

Fashetat e gizës me fileta duhet të mund të përdoren në tuba PE dhe PVC. Cilësia e tyre duhet të jetë e lartë në mënyrë që të kenë jetëgjatësi në përdorim. Presioni i punës që këto fasheta duhet të suportojnë, duhet të jetë PN16 ose dhe më i lartë. Fashetat duhet të jenë të veshura me pudër epokside me një trashësi minimalisht 250 μ m. Diapazoni i temperaturës së punës së këtyre fashetave duhet të jetë 0°C deri në +60°C (pranohet edhe diapazon me i gjerë që përfshijnë diapazonin e kërkuar). Fashetat duhet të shoqërohen me bulona prej materiali inoksi në mënyrë që të mos ndryshken.

Flete sharre

Fletat e sharrës ose ndryshe lamat e sharrës duhet të jenë cilësore dhe kenë jetëgjatësi të lartë. Ato duhet të mund të përdoren në çelik shumë të fortë deri në minimumi 1150 N/mm² ose dhe më të fortë. Fortësia e dhëmbëve të sharrës të jetë minimumi 65 HRC ose dhe më i lartë ndërsa fortësia e trupit të fletave të sharrës duhet të jetë minimumi 49 HRC (ose dhe më i lartë). Dhëmbëzat e këtyre fletave të sharrës duhet të jenë të valëzuara. Fletat e sharrës duhet të kenë kaluar një trajtim të dyfishtë termik në mënyrë që të reduktojnë goditjet.

Zgjatues bronzi

Zgjatuesit duhet të jenë material 100% bronzi. Presioni i punës së këtyre zgjatuesve të jetë minimumi 10 bar. Fundet e këtyre zgjatuesve duhet të kenë filetim mashkull. Filetimi i këtyre rakorderive duhet të jetë në përputhje me standartin ISO 228 ose ekuivalent me të. Temperatura e punës së këtyre rakorderive duhet të jetë të paktën -10°C deri në 95°C.

Saraçineskë me ajruer të inkorporuar.

Saraçineskat prej bronzi duhet të punojnë në presion minimumi 25 bar dhe në temperaturë -15°C deri +115°C. Saraçineskat duhet të kenë mbyllje sferike me kalim të integruar dhe hapje pozicionale. Të dy fundet e saraçineskës duhet të kenë filetim femër dhe të jenë konform standartit EN ISO 228 (ose ekuivalent). Si trupi dhe komponentët e tjerë të saraçineskës duhet të jenë prej bronzi. Saraçineskat duhet të jenë të pajisura me ajruer në trup, që të ketë mundësi të nxjerrë një sasi të vogël ajri në mënyrë që të mos ketë pengesa të ujit kur kalon në saraçineskë. Në saraçineskë duhet të jenë të shënuar të dhënat bazë si madhësia e

saraçineskës emri i kompanisë prodhuese ose ndonjë shenjë e markës etj. Të jenë të certifikuara për përdorim për ujë të pijshëm.

Saraçineskë me filtër të inkorporuar.

Saraçineskat prej bronzi duhet të punojnë në presion minimumi 30 bar dhe në temperaturë -10°C deri +105°C. Saraçineskat duhet të kenë mbyllje sferike me kalim të integruar dhe hapje pozicionale. Të dy fundet e saraçineskës duhet të kenë filetimit femër dhe të jenë konform standartit EN ISO 228 (ose ekuivalent). Si trupi dhe komponentët e tjerë të saraçineskës duhet të jenë prej bronzi. Saraçineskat duhet të jenë të pajisura me filtër në trup. Filtri është i pajisur me rrjetë (ose ndryshe sitë) në mënyrë që të ketë mundësi të mbledhë papastërtitë që mund të krijohen në tubacion. Në saraçineskë duhet të jenë shënuar të dhënat bazë si madhësia e saraçineskës, emri i kompanisë prodhuese ose ndonjë shenjë e markës etj. Të jenë të certifikuara për përdorim për ujë të pijshëm.

Tuba dhe rakorderi PPR

Tubat dhe rakorderitë PPR janë material polipropilen dhe kërkohen të jenë të përforcuara me fibra xhami. Duhet të kenë peshë të lehtë në mënyrë që transportimi dhe instalimi i tyre të jetë sa më i thjeshtë. Këto tuba dhe rakorderi duhet të jenë konform me standartin DIN 8077 ose ekuivalent me të. Transmetimi i dritës në këto tuba dhe rakorderi nuk duhet të jetë më shumë se 0.2% në mënyrë që të mos krijohen alga në to. Ato duhet të kenë qëndrueshmëri dhe rezistencë të lartë ndaj gjërryerjes. Tubat dhe rakorderitë nuk duhet të përmbajnë asnjë përbërës helmues apo kancerogjen, pra duhet të jenë të certifikuar për përdorim në ujë të pijshëm. Izolimi i tyre duhet të jetë i lartë në mënyrë që të parandalohet humbja e nxehtësisë. Tubat dhe rakorderitë PPR duhet të kenë një koeficient të ulët të përçueshmërisë termike, jo më shumë se 0.25 W/mK.

LLOJET DHE SASIA E ARTIKUJVE TË NEVOJSHËM

Nr.	Emërtimi i artikujve	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera për çdo artikull
1	Adapter 90 x 3"	copë	10		
2	Adapter 90 x 2"	copë	10		
3	Adapter 75 x 1 1/2"	copë	10		
4	Adapter 63 x 1 1/2"	copë	30		
5	Adapter 40 x 1"	copë	30		
6	Adapter 40 x 1 1/4"	copë	20		
7	Adapter 20 x 1/2"	copë	1000		
8	Adapter 20 x 3/4"	copë	300		
9	Bashkues PEHD 125	copë	5		
10	Bashkues PEHD 75	copë	50		
11	Bashkues PEHD 63	copë	50		
12	Bashkues PEHD 50	copë	400		

13	Bashkues PEHD 40	copë	300		
14	Bashkues PEHD 32	copë	500		
15	Bashkues PEHD 25	copë	1400		
16	Bashkues PEHD 20	copë	500		
17	Reduksion PEHD 110 x 90	copë	20		
18	Reduksion PEHD 110 x 75	copë	10		
19	Reduksion PEHD 90 x 50	copë	10		
20	Reduksion PEHD 75 x 40	copë	20		
21	Reduksion PEHD 75 x 50	copë	20		
22	Reduksion PEHD 75 x 63	copë	20		
23	Reduksion PEHD 63 x 32	copë	20		
24	Reduksion PEHD 63 x 40	copë	20		
25	Reduksion PEHD 63 x 50	copë	20		
26	Reduksion PEHD 50 x 40	copë	100		
27	Reduksion PEHD 40 x 32	copë	50		
28	Reduksion PEHD 32 x 25	copë	150		
29	Reduksion xingato 2" x 1"	copë	50		
30	Reduksion xingato 2" x 1 1/2"	copë	50		
31	Reduksion xingato 2" x 1 1/4"	copë	50		
32	Reduksion xingato 2" x 1/2"	copë	50		
33	Reduksion xingato 2" x 3/4"	copë	50		
34	Reduksion xingato 1 1/2" x 1"	copë	50		
35	Reduksion xingato 1 1/2" x 1 1/4"	copë	50		
36	Reduksion xingato 1 1/2" x 1/2"	copë	50		
37	Reduksion xingato 1 1/2" x 3/4"	copë	50		
38	Reduksion xingato 1 1/4" x 1"	copë	50		
39	Reduksion xingato 1 1/4" x 1/2"	copë	20		
40	Reduksion xingato 1 1/4" x 3/4"	copë	50		
41	Reduksion xingato 1" x 1/2"	copë	100		
42	Reduksion xingato 1" x 1 1/4"	copë	20		
43	Reduksion xingato 3/4" x 1/2"	copë	200		
44	Zgjatues 1/2 (5 cm)	copë	3000		
45	Zgjatues 1/2 (2.5 cm)	copë	3000		
46	Bërryla xingato 2"	copë	20		
47	Bërryla xingato 1 1/2"	copë	20		
48	Bërryla xingato 1"	copë	50		
49	Bërryla PEHD ø 200x90 mm	copë	5		
50	Bërryla PEHD ø 160x90 mm	copë	5		
51	Bërryla PEHD ø 90 mm	copë	10		
52	Bërryla PEHD ø 90 mm x 3"	copë	10		
53	Bërryla PEHD ø 50 mm x 2"	copë	30		
54	Bërryla PEHD ø 40 mm x 1"	copë	30		
55	Bërryla PEHD ø 32 mm x 1"	copë	140		
56	Bërryla PEHD ø 25 mm x 1/2" F.	copë	150		
57	Bërryla PEHD ø 20 mm x 1/2" F.	copë	100		
58	Bërryla PEHD ø 20 mm x 1/2" M.	copë	300		
59	Bërryla PPR 20 x 1/2" M	copë	100		
60	Bërryla PEHD 20 (90°) M	copë	300		

61	Ti xingato 1/2	copë	100		
62	Ti xingato 3/4"	copë	100		
63	Fasheta PEHD 140 x 1"	copë	10		
64	Fasheta PEHD 110 x 1 1/4"	copë	30		
65	Fasheta PEHD 110 x 1/2"	copë	50		
66	Fasheta PEHD 110 x 3/4"	copë	50		
67	Fasheta PEHD 90 x 1 1/2"	copë	10		
68	Fasheta PEHD 90 x 1 1/4"	copë	10		
69	Fasheta PEHD 90 x 1/2"	copë	10		
70	Fasheta PEHD 90 x 3/4"	copë	10		
71	Fasheta PEHD 90 x 1"	copë	10		
72	Fasheta PEHD 90 x 2"	copë	10		
73	Fasheta PEHD 63 x 3/4"	copë	24		
74	Fasheta PEHD 40 x 1"	copë	50		
75	Fasheta gize 250 x 1 1/2"	copë	10		
76	Fasheta gize 200 x 2"	copë	10		
77	Fasheta gize 160 x 1"	copë	10		
78	Fasheta gize 160 x 1 1/4"	copë	10		
79	Fashet Inox (Inoks) 400	copë	2		
80	Fashet Inox (Inoks) 300	copë	6		
81	Fashet Inox (Inoks) 250	copë	24		
82	Fashet Inox (Inoks) 100 - 120	copë	20		
83	Fashet Inox (Inoks) 90	copë	5		
84	Fashet Inox (Inoks) 80	copë	10		
85	Fashet Inox (Inoks) 50	copë	10		
86	Manikotë xingato 1/2"	copë	1000		
87	Manikotë xingato 1 1/2"	copë	50		
88	Manikotë xingato 2 1/2"	copë	10		
89	Manikotë xingato 2"	copë	50		
90	Manikotë xingato 3"	copë	10		
91	Manikotë xingato reduktuese 1 1/2" x 3/4"	copë	20		
92	Manikotë xingato reduktuese 1 1/4" x 3/4"	copë	20		
93	Manikotë xingato reduktuese 1"	copë	110		
94	Manikotë reduktuese 1 1/2" x 1 1/4"	copë	30		
95	Manikotë reduktuese 1 1/2" x 1/2"	copë	60		
96	Manikotë reduktuese 2" x 1 1/2"	copë	30		
97	Manikotë reduktuese 2" x 1 1/4"	copë	20		
98	Manikotë reduktuese 2" x 1"	copë	20		
99	Manikotë reduktuese 2" x 3/4"	copë	60		
100	Manikotë reduktuese 3/4" x 1/2"	copë	180		
101	Manikotë reduktuese 3/4" x 1"	copë	80		
102	Niples xingato 1 1/4"	copë	50		
103	Niples xingato 1"	copë	50		
104	Tapa DN 20	copë	500		
105	Tapa DN 25	copë	300		

106	Tapa DN 32	copë	30		
107	Tapa DN 40	copë	30		
108	Tapa DN 50	copë	30		
109	Tapa DN 63	copë	30		
110	Tapa DN 75	copë	30		
111	Tapa xingato 1"	copë	100		
112	Tapa xingato 3/4"	copë	500		
113	Tapa xingato 1/2"	copë	3000		
114	Tapa xingato 2 1/2"	copë	10		
115	Tapa xingato 3"	copë	10		
116	Tapa PPR 20 filete	copë	5000		
117	Saraçineskë DN 100	copë	5		
118	Saraçineskë DN 80	copë	5		
119	Saraçineskë 1"	copë	50		
120	Saraçineskë 1/2"	copë	1000		
121	Saraçineskë 1/2" me volant	copë	30		
122	Saraçineskë PN 25 DN 250 me fllanxhë	copë	2		
123	Saraçineskë PN 25 DN 200 me fllanxhë	copë	2		
124	Saraçineskë DN 150 me fllanxhë	copë	6		
125	Saraçineskë PN 25 ON 150 me fllanxhë	copë	2		
126	Saraçineskë PN 25 ON 100 me fllanxhë	copë	4		
127	Saraçineskë 3"	copë	5		
128	Saraçineskë 3" 16 atm	copë	5		
129	Saraçineskë 1 1/2" 16 atm bronxi	copë	20		
130	Saraçineskë DN 400 PN 25-40	copë	1		
131	Saraçineskë DN 300 PN 25-40	copë	1		
132	Saraçineskë DN 250 PN 25-40	copë	1		
133	Saraçineskë DN 200 PN 25-40	copë	1		
134	Saraçineskë DN 150 PN 25-40	copë	1		
135	Saraçineskë DN 100 PN 25-40	copë	1		
136	Elektromanikota 200 pn 16	copë	10		
137	Elektromanikota 160 pn 16	copë	50		
138	Elektromanikota 125 pn 16	copë	30		
139	Elektromanikota 110 pn 16	copë	20		
140	Elektromanikota 75 pn 16	copë	20		
141	Elektromanikota 63 pn 16	copë	20		
142	Tubo PEHO (PEHD) 300 PN 10.	ml	12		
143	Tubo PEHO (PEHD) 250 PN 10	ml	12		
144	Tubo PEHO (PEHD) 200 PN 10	ml	60		
145	Tubo PEHO (PEHD) 160 PN 10	ml	300		
146	Tubo PEHO (PEHD) 125 PN 16	ml	80		
147	Tubo PEHD (PEHD) 125 PN 10	ml	100		
148	Tubo PE 110 PN 16	ml	1000		
149	Tubo PE 110 PN 10	ml	2000		
150	Tubo PE ø 90 PN 16	ml	300		

151	Tubo PE ø 90 PN 10	ml	800		
152	Tubo PE ø 75 PN 16	ml	1000		
153	Tubo PE ø 75 PN 10	ml	1500		
154	Tubo PE ø 63 PN 16	ml	2000		
155	Tubo PE ø 63 PN 10	ml	2000		
156	Tubo PE ø 50 PN 16	ml	2000		
157	Tubo PE ø 50 PN 10	ml	5000		
158	Tubo PE ø 40 PN 16	ml	2500		
159	Tubo PE ø 40 PN 10	ml	4000		
160	Tubo PE ø 32 PN 16	ml	3000		
161	Tubo PE ø 32 PN 10	ml	5000		
162	Tubo PE ø 25 PN 16	ml	2000		
163	Tubo PE ø 25 PN 10	ml	5000		
164	Tubo PE ø 20 PN 16	ml	4000		
165	Tubo PE ø 20 PN 10	ml	6000		
166	Tubo PPR ø 20 PN 16	ml	300		
167	Tubo PPR ø 25 PN 16	ml	300		
168	Tubo PPR ø 32 PN 16	ml	10		
169	Fllanxha ø 250	copë	4		
170	Fllanxha çeliku 150	copë	20		
171	Fllanxha çeliku 100	copë	20		
172	Fllanxha çeliku 80	copë	10		
173	Fllanxha çeliku 50	copë	4		
174	Fllanxhë adapter 200	copë	10		
175	Fllanxhë + adapter 150	copë	10		
176	Fllanxhë + adapter 110 mekanike	copë	30		
177	Fllanxhë + adapter 75 mekanike	copë	30		
178	Fllanxhë + adapter 50 mekanike	copë	20		
179	Fllanxhë qorre ø 100	copë	15		
180	Fllanxhë qorre ø 150	copë	10		
181	Fllanxhë qorre ø 200	copë	5		
182	Fllanxhë qorre ø 250	copë	5		
183	Fllanxhë qorre ø 300	copë	5		
184	Fllanxhë qorre ø 400	copë	10		
185	Manometër 20 bar	copë	10		
186	Guarnicion 1"	copë	500		
187	Guarnicion 1/2"	copë	1000		
188	Guarnicion 3/4"	copë	1000		
189	Guarnicion DN 400	copë	10		
190	Guarnicion DN 150	copë	20		
191	Guarnicion DN 100	copë	20		
192	Guarnicion DN 80	copë	20		
193	Bulona + dado + rondele M 12	copë	100		
194	Bulona + dado + rondele M 14	copë	100		
195	Bulona + dado + rondele M 16	copë	100		
196	Bulona dado + rondele M 14 x 120	copë	100		

197	Bulona dado + rondele M 14 x 110	copë	100		
198	Bulona dado + rondele M 14 x 70	copë	100		
199	Bulona dado + rondele M 16 x 110	copë	100		
200	Bulona dado + rondele M 16 x 120	copë	100		
201	Bulona dado + rondele M 16 x 160	copë	100		
202	Bulona dado + rondele M 16 x 70	copë	100		
203	Bulona dado + rondele M 16 x 90	copë	100		
204	Bulona dado + rondele M 20 x 110	copë	100		
205	Bulona dado + rondele M 20 x 80	copë	100		
206	Ajrues 1/2" PN 16	copë	10		
207	Ajrues 1"	copë	20		
208	Ajrues 2"	copë	10		
209	Reduktor presioni 2"	copë	5		
210	Reduktor presioni 1 1/2"	copë	5		
211	Reduktor presioni 1 1/4"	copë	5		
212	Galixhan elektrik	copë	5		
213	Kundralvalvul 1/2"	copë	1100		
214	Kundralvalvul 3/4"	copë	300		
215	Kundralvalvul ø 1"	copë	10		
216	Kundralvalvul DN 100 PN 40	copë	1		
217	Kundralvalvul DN 150 PN 40	copë	1		
218	Kundralvalvul DN 200 PN 40	copë	2		
219	Kundralvalvul DN 250 PN 40	copë	1		
220	Kundralvalvul DN 300 PN 40	copë	1		
221	Kundralvalvul DN 400 PN 40	copë	1		
				Vlera pa TVSH	
				TVSH 20%	
				Vlera me TVSH	

**KËRKESA E MATERIALEVE QË DUHET TË PARAQITEN
MOSTRA**

Nr.	Emërtimi i artikujve	Njësia	Sasia
1	Adapter 20 x 1/2"	copë	1
2	Bashkues PEHD 32	copë	1
3	Bashkues PEHD 25	copë	1
4	Reduksion PEHD 50 x 40	copë	1
5	Reduksion PEHD 32 x 25	copë	1
6	Reduksion xingato 1" x 1/2"	copë	1
7	Zgjatues 1/2 (5 cm)	copë	1
8	Zgjatues 1/2 (2.5 cm)	copë	1
9	Bërryla PEHD 20 (90°) M	copë	1
10	Fasheta PEHD 110 x 3/4"	copë	1
11	Fashet Inox (Inoks) 100 - 120	copë	1
12	Fashet Inox (Inoks) 90	copë	1
13	Manikotë xingato 1/2"	copë	1
14	Manikotë xingato reduktuese 1"	copë	1
15	Tapa DN 20	copë	1
16	Tapa DN 25	copë	1
17	Tapa xingato 1/2"	copë	1
18	Tapa PPR 20 filete	copë	1
19	Saraçineskë 1/2"	copë	1
20	Saraçineskë 1/2" me volant	copë	1
21	Tubo PEHO (PEHD) 160 PN 10	ml	0.5 - 1 ml
22	Tubo PEHO (PEHD) 125 PN 16	ml	0.5 - 1 ml
23	Tubo PEHD (PEHD) 125 PN 10	ml	0.5 - 1 ml
24	Tubo PE 110 PN 16	ml	0.5 - 1 ml
25	Tubo PE 110 PN 10	ml	0.5 - 1 ml
26	Tubo PE ø 90 PN 16	ml	0.5 - 1 ml
27	Tubo PE ø 90 PN 10	ml	0.5 - 1 ml
28	Tubo PE ø 75 PN 16	ml	0.5 - 1 ml
29	Tubo PE ø 75 PN 10	ml	0.5 - 1 ml
30	Tubo PE ø 63 PN 16	ml	0.5 - 1 ml
31	Tubo PE ø 63 PN 10	ml	0.5 - 1 ml
32	Tubo PE ø 50 PN 16	ml	0.5 - 1 ml
33	Tubo PE ø 50 PN 10	ml	0.5 - 1 ml
34	Tubo PE ø 40 PN 16	ml	0.5 - 1 ml
35	Tubo PE ø 40 PN 10	ml	0.5 - 1 ml
36	Tubo PE ø 32 PN 16	ml	0.5 - 1 ml
37	Tubo PE ø 32 PN 10	ml	0.5 - 1 ml
38	Tubo PE ø 25 PN 16	ml	0.5 - 1 ml
39	Tubo PE ø 25 PN 10	ml	0.5 - 1 ml
40	Tubo PE ø 20 PN 16	ml	0.5 - 1 ml

41	Tubo PE ø 20 PN 10	ml	0.5 - 1 ml
42	Tubo PPR ø 20 PN 16	ml	0.5 - 1 ml
43	Tubo PPR ø 25 PN 16	ml	0.5 - 1 ml
44	Tubo PPR ø 32 PN 16	ml	0.5 - 1 ml
45	Fllanxhë + adapter 200	copë	1
46	Fllanxhë + adapter 150	copë	1
47	Fllanxhë + adapter 110 mekanike	copë	1
48	Fllanxhë + adapter 75 mekanike	copë	1
49	Fllanxhë + adapter 50 mekanike	copë	1
50	Guarnicion 1"	copë	1
51	Guarnicion 1/2"	copë	1
52	Guarnicion 3/4"	copë	1
53	Guarnicion DN 150	copë	1
54	Guarnicion DN 100	copë	1
55	Ajrues 1/2" PN 16	copë	1
56	Ajrues 1"	copë	1
57	Ajrues 2"	copë	1
58	Kundravalvul 1/2"	copë	1
59	Kundravalvul 3/4"	copë	1

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Afatet e lëvrimit:

Artikulli	Përshkrimi	Shuma	Destinacioni	Periudha e dorëzimit

Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRZGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*

b. *formularin e Ofertës sipas Shtojcës 1;*

c. *Listën e Çmimeve sipas Shtojcës 2.*

ç. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas përcaktimeve të bëra në Shtojcën 7 të DST-ve (Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit).

2.1.1 Të jetë qartësisht e specifikuar në QKB, se objekti i veprimtarisë së operatorit ekonomik është i njëjtë ose “ekuivalent” me objektin e prokurimit.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 (tre) vitet e fundit financiare (2021-2022-2023), ku vlera mesatare e së cilës, të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së llogaritur të kontratës.

2.2.2 Kopje të vërtetuar të bilanceve për vitet (2021-2022-2023) të paraqitur dhe konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse me nënshkrim dhe vulë si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të Ligjit nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ku bilancet e tre viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, të konfirmuar nga administrata tatimore.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit (2021-2022-2023) nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, vlera totale e të cilave duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuar gjatë këtyre tre viteve.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

2.3.2 OE ofertues duhet të paraqesë Autorizim Prodhuesi ose distributor zyrtar për mallrat objekt prokurimi. Në rast paraqitje të autorizimit nga distributori i autorizuar, operatori ekonomik duhet të provojë me dokument, lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

